




Republika e Kosovës



Kuvendi Komunal Gjiçan

Njësia e Prokurimit

Gjiçan me datë: 25.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiçanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **22.11.2019**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **K.N.T.SH "TEUTA – M " SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **" Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ultë "** me Nr. të Prok: **651-19-698-5-2-1** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik **K.N.T.SH "TEUTA – M " SH.P.K** e dt. **16.07.2019** lidhur me aktivitetin e prokurimit **" Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ultë "** me Nr. të Prok: **651-19-698-5-2-1** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës **12.07.2019** te publikuar ne platformën e prokurimit elektronik.

- 1. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, të datës 20.11.2019.**
- Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **K.N.T.SH "TEUTA – M " SH.P.K** me datë **16.07.2019**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **" Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ultë "** me Nr. të Prok: **651-19-698-5-2-1**, Autoriteti Kontraktues me datën **25.11.2019** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues pas analizimit dhe shqyrtimit të pikave të cilat janë kontestuar nga ana juaj ka konstatuar se:

Pretendimet e juaja ankimore nuk qëndrojnë pasi që:

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve i ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe ka vepruar në mënyrë transparente në harmoni me nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Pretendimi sa i përketë konfliktit të interesit për Udhëheqësin e Punishtes të cilin e keni paraqitur në ofertën tuaj dhe se i njëjti është zyrtarë brenda institucionit komunal më konkretisht zyrtarë në Drejtorin e Urbanizmit në Komunën e Gjilanit, në mënyrë që të jemi sa më transparent me ju kemi kërkuar informacion shtesë nga Organi më i lartë siç është Agjencioni Kundër Korrupsionit ashtu siç jeni në dijeni edhe ju.

Gjithashtu, që vlenë të ceket se duke u bazuar në Vendimin e OSHP-së me nr. 446/19 të datës 18.09.2019 shpalleni të Papërgjegjshëm dhe si rrjedhojë kemi kërkuar informacion shtesë nga Zyrja e Personelit sa i përket Zyrtarit Z. Ridvan Aliut ku si përfundim ky i fundit ende ushtron detyrën e Zyrtarit të Drejtorisë së Urbanizmit në kuadër të Inxhinier i Ndërtimtarisë .

Andaj komisioni për vlersimin e ofertave gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve duke u bazuar në *Ligjin mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe bazuar në rregullat e aprovuara nga KRPP të publikuara në webfaqen e KRPP-së -* ka konstatuar se Oferta e juaj është eliminuar për arsyet e lartë cekur.

Dhe bazuar në të gjitha dëshmitë që posedon AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv .

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

Izet Kurteshi

U.D. Zyrtar përgjegjës i Prokurimit